



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.06.2018 ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Caktimi i kohës së debatit, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, për të zhvillimin e diskutimeve për pikën e parë të rendit të ditës: “Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2017”

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Klajda Gjoshaj -	Nënkryetare e Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Kam thirrur Konferencën e Kryetarëve për të diskutuar në lidhje me kërkesën e bërë nga Grupi Parlamentarë i Partisë Demokratike për zhvillimin e diskutimeve në lidhje me raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Sipas nenit 103, pika 3 e Rregullores kërkesa për zhvillimin e debatit bëhet me shkrim nga një komision i përhershëm, nga një kryetari grupi parlamentar. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve në përputhje me nenin 48, pika 3 e kësaj Rregulloreje.

Çfarë mendimi kanë kryetarët e grupeve për kohën e debatit?

Edmond Spaho – Paraprakisht bëra një bisedë me zotin Balla. Ne kemi paraqitur 24 diskutantë dhe po t'i llogarisim nga 5 minuta secili shkojnë diku te 2 orë. Gjithashtu ne duam që, Kryeministri dhe Kryetari i Partisë Demokratike të mbajnë fjalën dhe të replikojnë, pasi mund të jetë e nevojshme për të sqaruar çështje që ngre secili. Për Kryeministrin dhe Kryetarin e PD-së të ketë një kohë prej 60 minutash, pavarësisht nga koha e grupit, dhe të flasin në varësi se si do të shkojë debati dhe në total koha të shkojë tek 3 orë diskutim.

Klajda Gjoshja – Edhe Lëvizja Socialiste për Integrim ka paraqitur kërkesën e saj për debat. Janë 10 diskutantë që do të flasin. Unë do të kërkoja që zëvendëskryetari i partisë zoti Luan Rama të mbante një fjalë rreth 15 minuta dhe më pas pjesa tjetër e deputetëve për kohën e mbetur që i takon, në total të jetë aty tek 1.5 orë diskutim.

Taulant Balla – Pra opozita kërkon 4.5 orë! Mendoj që do të ishte më mirë që Ju të konsumoni një kohë prej 3 orësh dhe ne 3.5 orë.

Gramoz Ruçi – Në këtë Konferencë Kryetarësh do të vendosim kohën e debatit në total për grupet parlamentare. Është e drejta Juaj që të përcaktoni kohën për kryetarët e grupeve dhe për çdo deputet të grupit tuaj brenda kohës që do të bihet dakord.

Përfundimisht e keni ndarë, 4.5 orë Ju si opozitë dhe mazhoranca 5.5 orë që, në total shkon 10 orë diskutime! Është kohë shumë e gjatë, mundësisht uluni në 3.5 orë debat Ju dhe mazhoranca të shkojë në 4 orë debat!

Edmond Spaho – Atëherë ne nga 3 orë po ulemi në 2.5 orë debat, por do të fillojmë diskutimin me zotin Basha.

Klajda gjosha – Edhe ne nga 1.5 orë po e lëmë për 1 orë debatin.

Taulant Balla – Gjithashtu dhe ne si mazhorancë po shkojmë në 4 orë debat.

Gramoz Ruçi – Atëherë vendosim që mazhoranca të ketë 4 orë diskutim dhe opozita 3.5 orë diskutim dhe në total të jetë 7.5 orë. Respektivisht:

- Grupi Parlamentarë i Partisë Socialiste – 4 orë.
- Grupi Parlamentarë i Partisë Demokratike – 2.5 orë.
- Grupi Parlamentarë i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim 1 orë.

Faleminderit për pjesëmarrjen, mbledhjen e mbylli këtu për të vazhduar me seancën plenare.

MBLEDHJA MBYLLET